



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT - OPŠTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Nr. i fakteve Nr. fakta NFK-2025	Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit.
10	10-08-2025/13870/25
Nr. ifaqeve Br. stranica NFK-2025	Hr. Prot. Br. Prot. Prot. N.
4	Data Datum Date
22.08.2025	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

ODBOR ZA POLITIKU I FINANSIJE

COMMISSION FOR POLITICS AND FINANCE

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal

24.07.2025

Takimi i mbajtur me datën 24.07.2025 në hapësirat e Komunës së Mitrovicës Veriore me fillim në ora 10:00.

Në takim janë të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Nedzad Ugljanin
2. Flutura Hamza - Azemi
3. Aida Ferati - Doli
4. Gzim Alushi
5. Dusan Milunovic

Të pranishëm të tjerë Mevlude Shala drejtoresha e financave.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Nedzad Ugljanin, ku si fillim përvihendeti të pranishmit

Rendi i ditës sipas rregullores se kuvendit

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2 Raporti gjashtëmujor finanziar Janar-Qershori 2025
- 3.Vendimi per skulptorin grupi Mak

- 4.Rregullorja per taksa, tarifa dhe gjoba
5. Raporti Gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës
6. Raporti Gjashtëmujor i K.K të Mitrovicës Veriore
7. Raporti Gjashtëmujor i zv. Kryesuesit për Komunitete
8. Raporti Gjashtëmujor i Komitetit për Komunitete
- 9.Kerkesat e qytetarëve
10. Kërkesë për trasferimin e 20 pozitave të stafit nga kodi buxhetor 75170 në kodin buxhetor 85118 për vitin fiskal 2025
11. Të ndryshme

Rendi i ditës votohet me 5 vota për

Kryesuesi: Pika e parë është miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar dhe shohë se është e përfshir shumica e fjali me që kemi mbajtur secili nga ne, keni diqka për të shtuar?

Gzimi: Vetëm deshta ta falenderoj procesmbajtësin i cili për herë të parë shohë një raport që është përfshir shumica e rasteve që deri më tanë nuk ka ndodhur, kurse tanë e kam lexuar dhe kam ndje kënaqësi për punën e mirë që është bërë, faleminderit shumë kjo na takon që të përfshihet e gjitha dhe mos tw harrohen.

Mevlude:Përvendetje për të gjithë kam pranuar një kërkes nga drejtoria për shërbime publike kërkes për Rialokimin e mjeteve në kategorin ekonomike investime kapitale, andaj kam përgatit si kërkes për kuvendin nëse është e mundur tanë të hyje në rendin e ditës, gjithashtu Plani i veprimit të rekomandimeve për zbatimin për shkak të performances është mirë që të hyjë në rend dite në kuvend të diskutohet, e kam dërguar planin e rekomandimeve në email por nuk e pash në rend dite si pikw propozoj të jetë edhe ajo që të diskutohet për shkak se kërkohet për raport tw pwrformances.

Kryesuesi:Neve na vjen mirë që punët shkojn përpara sidomos investimet kapitale, por këtë temë kam dashur ta hapi edhe si temë në kuvend sepse disa punë që ne kemi parashikuar sipas linjës buxhetore dhe për investimet kapitale tanë janë para aktit të kryer, sepse ne këto rrugë si kemi parashiku me buxhet, sepse siq e dini ata kan punuar por tash kur përfundojn punët i sjellin këtu në kuadër të kuvendit, ne i vendosim në rendin e ditës por për këtë temë dhe këtë rend dite do bisedoj sepse janë disa projekte kapitale që p.sh Kodra minatorëve ende ska filluar, edhe disa projekte në fakt eksekutivi për këto projekte nuk ka pyet kuvendin, dhe nuk është përmbytj vendimeve të kuvendit kur kemi votuar linjën buxhetore, por meqenëse shkojn punët mbarë për qytetaret dhe rrugët nuk është problem, sepse ne kur kemi kërkuar mirëmbamjtjen varrezave muslimane në pjesën veriore, ata në fakt i perfundojnë projektet pa dijen e kuvendit, dhe tash kërkojn aprovimin e kuvendit sepse nuk e kemi parashikuar në linjën buxhetore, por ne do i vendosim këto dy pika në rend dite.

Mevlude: Drejtoresha Erza Mustafa ka bërë kërkes me datë 22.07.2025 ku ka njoftuar që kan probleme proënsore të evdientuara tek ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit përgjatë Mitrovicës së Veriut dhe kan dashtw që me implementin të këtij projekti që ajo pronë është private, për shkak të problemit pronënsor nuk mundet të implementohet ky projekt dhe ato mjete që janë 140.000

Euro që janë parashikuar të mos shkojn subvicit kanë bërë kërkes që ato mjete të njëjta të rialokohen tek mjetet eksistuese per shkak që kan dal punë shtesë dhe kanë nevoj pér mjete më shumë.

Dushani: Me falni drejtoresh a eshte rruga e kanalit te Zveqanit rruges ndermjet Bergjanit dhe Kodres Minatoreve ?

Mevlude: Drejtoresha me ka informuar qe kan pasur takim me KRU Mitrovica me drejtorin eksekutiv dhe ai ka theksu se menaxhimi i ujësjellësit nw veri ka kalu ne kompetencw te tyre, wshtw përgjegjësi e ujwsjellsit qw ata tw meren me kwtw problem.

Kryesuesi: Vazhdojm me pikën e parë Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar, kush është pér, të gjithë jan pér dhe procesverbal votohet me 5 vota pér.

Kryesuesi: Vazhdojm me pikën e dytë, drejtoresh Melude urdhëroni .

Mevlude: Përshendetje pér tē gjithë, në kuadër tē transparencës dhe llogaridhëniejës jam këtu sot para jush pér raportin gjashtëmujor financiar Janar-Qershorr 2025, dhe fillon tē paraqes këtë raport gjashtëmujor.

Kryesuesi: Kam një pyetje siq e dini me datë 31.01.2025 keni sjell vendim pér subvencionim e fëmijëve tē lindur pér 2025 si dhe pér qiftet e reja që kurorëzohen gjatë vitit 2025 subvencionimin e menjëhershëm tē fëmjeve me nevoja tē veqanta dhe vendimin per pagesën e anëtarëve tē komiteteve tē themeluar nga kuvendi i komunës dhe vendimi pér procesmbajtësen këto janë se nuk i shoh në kuadër tē raportit financiar dhe që janë aprovuar nga kuvendi. Sa i përket atyre ne ende skemi marrë, është komisioni që mledh disa sikurse vitin e kaluar në tremujorin e fundit i kemi bërë pagesat, dmth mledhen kërkesat që janë per raste vendim dhe në fund bëhet pagesa.

Kryesuesi: Këtë e them sepse në fillim viti janë aprovuar këto vendime dhe pér fëmijët me nevoja tē veqanta është i rëndësishëm.

Mevlude: Përderisa është komisioni që i verifikon kërkesat bëhet propozimvendimi vendimi dhe pastaj vjen tek ne në drejtori dhe ne ende nuk kemi asgjë, as per lindje as per martesa, nuk di nëse ka aplikime akoma.

Kryesuesi: Ne kemi dëshir që tē përfundojn këto para se tē perfundojn mandati ynë, sidomos pér femijë me nevoja tē veqanta, ne duhet tē jemi shumë tē kujdeshëm dhe tē bëjm presion që tē përfundojn deri në fund tē mandatit si anwtar tē kuvendit, sepse ligjshmërisht duhet patjetër tē paguhet, unë do mar hapat konkret në këtë drejtim në mënyr juridike tē jem aty, tē paditet komuna pér mos pages, komunisoni pér komunitete është një komision i obliguar.

Kryesuesi: Drejtoresh faleminderit pér raportin.

Gzimi:Me tē vërtet me qudit fakti se ne kemi votuar dhe përfundon nga ana jonë e gjitha kurse realisht spo përfundon asgjë, kur ka propozuar Znj Aida këtë kërkes pér këta femije ende ska asgjë, kurse ende pa pwrfunduar këta i paskan siguru mjetet tē kthejn, tē hiqen nga aty dhe tē vendosen këtej po gjindet mundësia, ndërsa kërkesat tona kanë tē drejt qytetaret kur na thojn e

ngritni dorën votoni dhe ska asgjë rezultati zero

Kryesuesi: Gzim ato nuk jan parashiku në buxhet, ne e dijm se qka votojm në kuadër të buxhetit, ata perfundojn punë mandej kerkojn dislokim te mjeteve.

Dushani: Pyet se i cili eshte marre vendimi pwr ndihm shwndetsore Slobodan Stepiq meqenëse rasti eshte urgjent?

Mevlude: Deri sa te hapet id e furnitorit nga Prishtina dhe mw pas te bwhet pagesa

Dushani: Une nuk dua te jem pjes e atij komisioni per formimin e emrave te rrugeve, edhe para mediava kam then qe nuk dua te jem anwtar pwr komision per formim tw rrugëve dhe nuk i di gjysmën e emrave te rrugëve nw qytet.

Aida: Në rregull vetëm më duhet si dëshmi që të kemi në procesverbal se është i ftuar personi në fjalë pér komisionin që jemi duke mbjatur.

Kryesuesi: Kemi piken tjetër kérkesat e qytetarëve ku kemi disa kérkesa ku janë më shumë pér shëndetësi, sepse këta në fakt nuk kan apliku kur ka qen i hapur aplikimi pér qytetarë ku kemi dy raste me hemoterapi dhe një rast kemi me bypas dhe një tjetër pér mjekim dhe me ato mjete që kemi është mirë që të ju ndihmojm ne si kuvend meqenëse skan apliku kur ka qen aplikimi pér qytetarë.

Kryesuesi: Ne si kuvend komunal duhet të punojm që të mbrojm 19 vende pér asamblesit sepse na ka ardhur 15 vende sipas statistikave të regjistrimit, sepse statistika sa janë regjistruar ka dhe fëmije që s'kan drejt vote, por ne jemi të obliguar të drejtohemë Ministris,KQZ pér përmirësimë sepse nuk mund të jemi në nivel të komunav tjera p.sh Zveqani apo Novoberda sepse kan më pak banor si qytete, kurse ne kemi afér 20.000 banor


Aida: Këtë kérkes duhet më herët të bëhet para se të dalin listat votuese në KQZ është më problematike të bëhet pastaj.

Kryesuesi: Nëse nuk keni diqka pér të shtuar ju falenderoj pér pjesëmarje, shihemi në takimin e ardhshëm.

Mbledhja përfundoj ne orën 11:50

Procesmbajtës:

Bujar ISUFI



Nedzad UGLJANIN